



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600203/2

Tiranë ____/____/2016

Lënda : Rekomandohet *"Fillimi i hetimit te procedimit disiplinor ndaj z.M. N., me detyrë Referent i Specialistëve të Policisë së Zonës në Komisaratin e Policisë Lezhë, për kryerje të veprimeve të paligjshme ndaj qytetarit L. Gj."*

Drejtuar : **Shefit të Komisarariatit të Policisë
Z. Besim PALAMANI**

LEZHË

Për dijeni: **Drejtorit të Drejtorisë të Standarteve Profesionale
Z. Dylaver SHIMA**

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit , më datë 12 Shkurt 2016, ka paraqitur ankesë shtetasi L. Gj.,banues në Kakariq, Balldre të Lezhës, i cili ka ngritur pretendimin se më datë 09.02.2016, punonjësi i Komisarariatit të Policisë Lezhë, M. N., ka kryer veprime të paligjshme ndaj tij, duke i vendosur prangat në duar dhe shoqëruar padrejtësisht në mjediset e Policisë.
Shtetasi L. Gj., duke qënë i pajisur dhe me pasaportë amerikane, pas ngjarjes ka njoftuar dhe ambasadën amerikane në Tiranë.

Mbi këtë shqetësim, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në marrjen e deklarimeve të ankuesit L. Gj., punonjësive të policisë M. N., e N. Gj., si dhe administruar dokumente të ndryshme si, deklarata, formularë dhe fletë nga regjistri i evidentimit të personave të shoqëruar në Komisaratin e Policisë Lezhë datë 09.02.2016.

Rrethanat e ngjarjes

Në deklaratimet e tij shtetasi L. Gj., ka shpjeguar se në ditën e ngjarjes datës 09.02.2016, rreth orës 12.00, ka qënë tek prona e tij, kur ka parë në distancë 50 metra tezen e tij T. V., (persone me të cilën nuk ka marrëdhënie të mira), që bërtiste e më pas mori në telefon Policinë. Rreth orës 13.00 shtetasi L. Gj., ka shkuar tek një lokal i fshatit, ku pasi ka parë që aty ka ardhur mjeti fugon i policisë, ka dalë duke u afruar pranë tij. Punonjësi i policisë M. N., i ka thënë se duhet të vinte në Polici, pasi kishte rrahur një grua. Ai ka pranuar thirrjen e punonjësit të policisë dhe ka hyrë në fugon, në të cilën ndodhej dhe teza e tij T. V. Në këto momente punonjësi i policisë M. N., i ka thënë kolegut P. T., që t'i vendosë prangat në duar dhe ai ashtu veproi. Punonjësi i policisë M. N., ka dashur të kryejë kontroll në banesën e shtetasit L. Gj., duke e pyetur nëse kishte armë pa lejë, por nuk e ka realizuar atë pasi ka konfirmuar prej tij se nuk disponon ndonjë send të kundërligjshëm në banesë.

Në rrethanat e paraqitura, pasi kishin kaluar 10-15 minuta, i shqetësuar për vendosjen padrejtësisht të prangave, shtetasi L. Gj., i sqaron punonjësit e policisë se ai nuk kishte bërë asgjë, nuk kishte rrahur njeri dhe se nuk ishte i dhunshëm. Pas këtij momenti shtetasit L. Gj., i janë hequr prangat nga duart. Vendosja e prangave shtetasit Landi Gjoni pranohet nga punonjësit e policisë N. Gj., dhe M. N., por ky i fundit në shpjegimet e tij pretendon se arsyeja e vendosjes së tyre ishte se, shtetasja T. V., po bërtitse dhe thonte se L., e kishte qëlluar atë.

Konstatime dhe përfundime

Duke parë dhe analizuar veprimin e kryer nga punonjësi i Policisë M. N., konstatohet se vendosja e prangave në duar shtetasit L. Gj., është i paligjshëm dhe abuziv. Kjo për faktin se prej tij nuk ishte kryer ndonjë veprë penale siç mund të ishte "Rrahja", çka u konfirmua dhe me pohimin e tezes së tij T. V. Ky veprim bie ndesh me nenin 2 të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit: në të cilën shprehet qartë se misioni i Policisë së Shtetit është që të garantojë zbatimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Nga ana tjetër, trajtimi i shtetasit L. Gj., në cilësinë e personit të shoqëruar bie ndesh me nenin 109 të ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

Po ashtu, veprimi i punonjësit të policisë M. N., vjen në kundërshtim me nenin 105 të V.K.M-së nr. 750 datë 16.09.2015 "Për miratimin e Rregullores së Policisë të Shtetit" ku thuhet: *"Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimit, plotësimit të detyrave dhe komunikimit të punonjësit të Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me*

standartet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Ndërsa në nenin 107 të Rregullores së së Policisë së Shtetit, i cili bën fjalë për Përgjegjshmërinë, thuhet se: *“Në themel të punës dhe veprimtarisë së tij, punonjësi i policisë mbështetet mbi parimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies ndasj publikut. Punonjësi i policisë mban përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet e tij, të cilat shkojnë ndesh me zbatimin e ligjit”.*

Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t’i përshtaten parimeve të demokracisë, zbatimit të ligjit, llogari-dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Punonjësve të Policisë së Shtetit, duhet t’ju bëhet e qartë fakti se, janë një grup veprash penale siç është edhe “Rrahja” të cilat sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, e vendosin personin në cilësinë e të dëmtuarit akuzues. Prandaj sipas nenit 59 të K.Pr.Penale, qytetari duhet të bëjë kërkesë të cilën e paraqet në gjykatë, ku merr pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Prandaj, për çdo rast që qytetarët njoftojnë Policinë, apo paraqiten pranë S.P.Z-ve për të bërë kallëzim penal, ata duhet t’i njohin me kërkesat e neneve 59 dhe 60 të Kodit të Procedurës Penale për bërjen nga ana e qytetarëve të kërkesës dhe formulimit të saj në mënyrë të plotë e të saktë dhe më pas depozitim në sekretarinë e gjykatës.

Rasti i përmëndur më sipër për vendosjen e prangave dhe shoqërim të paligjshëm të qytetarit L. Gj., duhet të bëhet objekt i një analize në strukturat e Policisë Vendore, me qëllim marrjen e masave që shkeljet e konstatuara të mos përsëriten në të ardhmen.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,*

REKOMANDOHET

“Fillimi i hetimit te procedimit disiplinor ndaj z.M. N., me detyrë, Referent i Specialistëve të Policisë së Zonës në Komisariatit e Policisë Lezhë, për kryerjen e veprimeve të paligjshme ndaj qytetarit L. Gj.”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Ankesa e shtetasit L. Gj., dhe proces verbal i marrjes së deklarimeve të tij datë 18 Shkurt 2016.
2. Proces Verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit M. N., datë 18 Shkurt 2016.
3. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit N. Gj., datë 18 Shkurt 2016.
4. Deklaratë e shtetasit L. Gj., datë 09.02.2016.
5. Formular për personin e shoqëruar L. Gj., dhe fletë të regjistrimit të evidentimit të të dhënave të personave të shoqëruar, datë 09.02.2016.
6. Komunikata e Komisarit të Policisë Lezhë, datë 09.02.2016.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI